



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.

Tiranë më 13.03.2026

V E N D I M

Nr. 7, datë 13.03.2026

PËR

“MIRATIMIN E DOKUMENTIT “RREGULLORE E ANALIZËS SË TREGUT””

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare znj. Dania Nallbani, në mbledhjen e datës 13 mars 2026, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- “Miratimin e dokumentit “Rregullore e analizës së tregut””

BAZË LIGJORE:

1. Pika 1 e nenit nenit 89, si dhe përcaktimet e Kreut XIII, XIV dhe XV të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.
2. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr. 21, datë 7.12.2021.

KËSHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti përfundimtar “Projektregullore e analizës së tregut”;
2. Komentet e palëve të interesuara dhe qëndrimi i AKEP;
3. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
4. Relacioni shoqërues i Projektvendimit,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 27, datë 14.11.2025, ka miratuar për Këshillim Publik dokumentin “Projektregullore “Për analizën e tregut”.
2. Procesi i këshillimit publik për dokumentin “Projektregullore “Për analizën e tregut”, sëbashku me Ankesin I të saj, u zhvillua për një periudhë 30 ditore, nga data 17.11.2025 deri më datë 16.12.2025. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, pranë AKEP, janë depozituar komente nga palë të interesuara, konkretisht:
 - me shkresën nr.1030, prot., datë 26.11.202, komente nga Autoriteti i Konkurrencës (AK), si dhe
 - me shkresën nr. 2499, prot., datë 16.12.2025, komente nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a.
3. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i komenteve të ardhura, AKEP, konstaton se këto komente nuk kërkojnë ndryshime në Projektregulloren “Për analizën e tregut”, dhe dokumenti final miratohet duke ruajtur përmbajtjen, strukturën dhe metodologjinë e versionit të këshilluar me palët e interesuara.
4. Dokumenti “Projektregullore “Për analizën e tregut””, miratohet nga AKEP duke u bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, konkretisht:
 - Në nenin 89, pika 1 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i cili ngarkon AKEP-in me kompetencën për të kryer analizën e tregjeve dhe për të miratuar aktet rregullatore përkatëse;
 - Nenet 87, 88, 90 dhe 92 të ligjit nr. 54/2024, që rregullojnë përkufizimin e tregjeve përkatëse, vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) dhe vendosjen, ndryshimin ose heqjen e detyrimeve rregullatore;
 - Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrotjtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar;

- Rekomandimin (BE) 2020/2245 të Komisionit Evropian për tregjet relevante të ndjeshme ndaj rregullimit “ex-ante”;
 - Udhëzuesin e Komisionit Evropian për analizën e tregut dhe vlerësimin e FNT (C/2018/2374), si dhe praktikën e BEREC.
5. Dokumenti përfundimtar i AKEP, “Projektregullore “Për analizën e tregut”, përmban:
- procedura të detajuara për vlerësimin e tregjeve dhe të fuqisë së ndjeshme në treg, duke siguruar mbikëqyrje të drejtë dhe transparente nga AKEP;
 - mekanizma për konsultimin publik, miratimin e masave rregullatore, rishikimin dhe monitorimin e tregjeve, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe angazhimet ndërkombëtare;
 - përcakton listën e tregjeve për ndërhyrje ex-ante dhe procedurat për identifikimin e tyre, në përputhje me ligjin nr. 54/2024;
 - përfshin dispozita mbi detyrimet e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg, masat rregullatore përkatëse dhe mekanizmat e ndërhyrjes ex-ante, me synim krijimin e një tregu më konkurrues dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve fundorë;
 - Aneksin I, që përmban “Udhëzim për procesin e analizës, përcaktimin e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së ndjeshme në treg (FNT) në sektorin e komunikimeve elektronike”, i përgatitur në referencë të ligjit nr. 54/2024 dhe në përputhje me Udhëzuesin e Komisionit Evropian për analizën e tregut. Ky udhëzim do të shërbejë si referencë metodologjike për të gjitha proceset e analizës që zhvillohen nga AKEP.
 - dispozitat mbi detyrimet e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg, masat rregullatore përkatëse dhe mekanizmat e ndërhyrjes ‘ex-ante’, me synim krijimin e një tregu më konkurrues dhe mbrojtjen e interesave të përdoruesve fundorë.
 - nga pikëpamja e ligjshmërisë është konform me përcaktimet ligjore të Kreut XIII, Kreut XIV dhe Kreut XV të ligjit nr. 54/2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të pikës 1 të nenit 14, dhe pikës 1 të nenit 15, ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentin “Rregullore e analizës së tregut”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky Vendim dhe Dokumenti “Rregullore e analizës së tregut”, të publikohen në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.

3. Rregullore nr. 9, datë 17.07.2009 “Për analizën e tregut”, miratuar me VKD nr. 747, datë 17.07.2009, e ndryshuar, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Drejtoria Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka